

Njoftim për aplikim për licencim

Në zbatim të nenit 43, pika 1 dhe 136, pika 2, e ligjit nr. 59/2026 “*Për sektorin e energjisë elektrike*”; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë se shoqëria “ALBPOWER” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

Në mbledhjen e datës 28.08.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ALBPOWER” shpk në këtë veprimtari.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me kërkesën për licencim, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 01.09.2026 deri më 10.09.2026), pranë zyrave të ERE-s, në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr.7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al.